



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 2410 Prot

Tiranë, më: 11.03 2020

URDHËR

Nr. 76 Datë 11.03.2020

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE ORGANIZATIVE DHE
ADMINISTRATIVE NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT, NË KUADËR
TË PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 gërma “d” të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit nr.132, datë 08.03.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, në kuadër të masave parandaluese për sëmundjen infektive COVID 19,

URDHËROJ:

1. Rritjen e masave higjieno – sanitare në të gjitha mjediset e punës së MTM dhe institucioneve në vartësi të saj, si dhe dezinfektimin e ambienteve të brendshme të godinës.
2. Të gjitha proceset e punës që lidhen me shërbimet on-line që ofron Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, gjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID 19, do të vijojnë përmes sistemit elektronik dhe përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.
3. Për proceset e tjera të punës të reduktohet maksimalisht ekspozimi dhe kontakti fizik i punonjësve me njëri-tjetrin, por edhe me qytetarët, duke përdorur komunikimin elektronik apo përmes postës zyrtare.
4. Dhënien leje për punonjësit “prind kujdestar” në MTM dhe strukturat e varësisë, konform udhëzimeve të dhëna, të cilët duhet të kujdesen për fëmijët në cerdhe, kopshte dhe arsimi i ulët, sipas hapave të mëposhtëm:
 - a) cdo punonjës i drejtohet me shkresë zyrtare titullarit të Institucionit, ose Sekretarit të Përgjithshëm, duke deklaruar se nga familja e tij do të jetë personi që do të kujdeset për fëmijën në poshën e përcaktuar që përfshihet në kategorinë e VKM-së, duke dhënë emrin/mbiemrin e bashkëshortit/bashkëshortes dhe vendin e punës.

- b) Në rastin kur konstatohet se dy prindërit janë vetdeklaruar si kujdestarë të të njëtit fëmijë, atëherë institucioni i komunikon babait/mamasë së fëmijës se duhet të kthehet në punë, në të kundërt do të aplikohen masat përkatëse administrative.
5. Të gjithë nëpunësit të cilët do të kryejnë punën e tyre në distancë, të marrin masa për aksesimin e e-mailit zyrtar (në laptop apo telefon mobile) dhe disponibilitetin e tyre për çdo rast nevojë pune.
 6. Anulimin e të gjitha aktiviteteve publike të planëzuara brenda dhe jashtë vendit, deri në datë 3 prill 2020.
 7. Dokumentet e ardhura në MTM nga institucione të tjera apo individë do të pranohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar.
 8. Nëpunësit e Protokollit që do të pranojnë dokumentacion hyrës në MTM, si dhe nëpunësit e informacionit, si pritësit e parë të qytetarëve të ndryshëm që paraqiten në institucion, duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse dhe elementët e tjerë të sigurisë.
 9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse të hartojë listën e punonjësve që do të punojnë në distancë, si dhe listën e punonjësve të cilët duhet të paraqiten fizikisht në punë. Po ashtu, të njoftojë të gjithë punonjësit për përmbajtjen e këtij Urdhri, si dhe udhëzimin e tyre për zbatimin me rigorozitet të rregullave të nevojshme për situatën, për të mos vënë në rrezik veten dhe të tjerët, deri në përfundimin e kësaj periudhe.
 10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet i gjithë stafi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe i institucioneve në varësi të saj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të MTM dhe të afishohet në hyrje të ambienteve të institucionit.

MINISTËR

Blendi KLOSI

